



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 07
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 18 mars 2015, në orën 11:00.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Adem Hoxha.

Të ftuar: përfaqësues të shoqatës “Down Syndrome Kosova”, znj. Sebahate Beqiri, Afrim Sahiti, si dhe Leunora Shabani-Bajraktari.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 11.2.2015;
3. Takim me shoqatën “Down Syndrome Kosova”;
4. Raportimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit nr. 04/L-008, për Këshillin Ekonomiko-Social;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 11.2.2015

Kryetarja, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 11.2.2015, pa vërejtje.

3. Takim me shoqatën “Down Syndrome Kosova”

Kryetarja – Kemi kënaqësinë që në mesin tonë të kemi prezent, përfaqësuesit e shoqatës “Down Syndrome Kosova”. Ju faleminderit që iu keni përgjigjur ftesës së Komisionit, për të raportuar lidhur me punën dhe vështirësitë e shoqatës që e drejtoni. Sot është Dita Ndërkombëtare e Sindromit Down dhe sigurisht është momenti që të sensibilizojmë opinionin për problemet që ballafaqohen prindërit që kanë fëmijë me sindromin Down.

Sebahate Beqiri – E nderuara kryesuese, të nderuar deputetë!

Ju faleminderit për ftesën dhe për mundësinë që na keni dhënë, që ne si shoqatë dhe prindër të fëmijëve me sindromin Down, të prezantojmë para jush problemet apo vështirësitë që ballafaqohemi gjatë punës sonë të përditshme.

Ne jemi organizatë e cila është themeluar prej prindërve, të cilët kanë fëmijë të prekur me sindromin Down. Ne si shoqatë, për çdo ditë ballafaqohemi me sfida të ndryshme, sa i përket integritetit, edukimit dhe arsimimit të këtyre fëmijëve. Më lejoni fillimisht t’i përmendi disa ligje, të cilat këtyre fëmijëve iu garantojnë këto të drejta. Në kuadër të Ligjit për arsimin para-universitar, të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh nevojat e tyre fizike dhe psikike, duhet të jenë brenda shkollave publike. Ne, nga viti 2007, kur jemi themeluar, kemi filluar me integrimin e fëmijëve nëpër shkollat publike. Gjithashtu, kemi nisur hartimin e strategjisë për gjithëpërfshirjen e fëmijëve në edukimin dhe arsimimin e rregullt, një strategji 5 vjeçare, në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Strategjia 2010-2015. Fatkeqësisht as 20 % e objektivave të asaj strategjie, nuk janë implementuar. Kurse sa i përket shërbimeve, në kuadër të ligjit për përkrahje të familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, parashihet që nga moshja 1 e deri në 18 vjeç, përfutet të kësaj skeme të jenë familje që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara. Në këtë rast, çka për foshnjat e porsalindura 0 deri 12 muaj? Ne kërkojmë nga ju që këtë ligj ta analizoni dhe të shqyrtoni mundësinë e ndryshimit, sepse në këtë ligj ka edhe nene tjera të paqarta. Ne kërkojmë nga ju që të kemi një strategji që personat me aftësi të kufizuara të trajtohen për jetë të pavarur, pra të mos jenë përfitues të skemave pensionale. Është ofendim për një person të moshës 18 vjeçare të futet në skemat pensionale. Besojmë se jeni të informuar që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është në përgatitje të koncept-dokumentit për një projektligj gjithëpërfshirës për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Ne jemi pjesë e këtij grupi dhe sot kërkojmë nga ju që ky proces të ketë mbështetjen e tuaj gjatë shqyrtimit në Kuvend, ku me këtë do të trajtohen të gjitha kategoritë në mënyrë të barabartë dhe mos të kemi diskriminim në mes të këtyre kategorive. Ne si shoqatë, nesër kemi organizuar gala mbrëmjen për nder të Ditës së Syndrome Down, me qëllim të mbledhjes së fondeve për ndërtimin e qendrës për këta persona. Ne, përveç zyrës që kemi në Prishtinë, kemi edhe 4 zyra tjera, në Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj dhe Prizren. Ne si shoqatë kemi themeluar edhe programin X21, si dhe jemi në proces të themelimit të ndërmarrjes sociale ku do të punësohen këta persona të prekur me sindromin Down.

Afrim Sahiti - E nderuara kryesuese, të nderuar deputetë!

Ju faleminderit për ftesën, si dhe për mundësinë që na keni dhënë që para jush të prezantojmë punën dhe vështirësitë tona. Ne si shoqatë, i kemi katër objektiva strategjike: ngritjen e nivelit të vetëdijes së fëmijëve, familjarëve, institucioneve dhe shoqërisë në përgjithësi për personat e prekur nga sindromi Down. Krijimin e partneritetit të qëndrueshëm dhe afatgjatë me institucionet

qendrore dhe lokale, OJQ-të e personave me aftësi të kufizuara, të organizatave vendore dhe ndërkombëtare. Po ashtu, përkrahjen gjithëpërfshirëse të personave të prekur me sindromin Down, ofrimin e shërbimeve shëndetësore profesionale, përfshirjen në sistemin edukativo-arsimor të hershëm, shkollim fillor dhe të mesëm dhe ofrimin e mundësive për punësim integruar. Andaj, ne kërkojmë nga ju si Komision parlamentar dhe nga të gjitha institucionet shtetërore, në përmbushjen e këtyre objektivave tona strategjike. Po ashtu, ne kërkojmë që të iniciohet ndryshimi i Ligjit për kujdestarinë e personave me aftësi të kufizuar dhe përmes tij të bëhet njohja e statusit të kujdestarit ligjor të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Rishikimi i skemës së pensionit të personave me aftësi të kufizuara, kërkojmë harmonizim dhe rritje bazuar në nevojën ekonomike dhe sociale. Implementimi i programit të licencimit të ofruesve të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, rritja e ndihmës materiale për fëmijët me aftësi të kufizuara nga 1 deri në 18 vjet, themelimi i fondit për mbështetjen financiare të ofruesve të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, krijimi i fondit për krijimin e lehtësirave ekonomike dhe sociale, lehtësira në transport, energji elektrike, doganore etj.

Leunora Shabani-Bajraktari - Fillimisht, më lejoni t'ju falënderoj ju kryetare dhe të gjithë anëtarët tjerë të Komisionit. Unë do të ndalem tek çështja e trajtimit të lehonave dhe nënave pas lindjes së fëmijës së tyre të cilët janë të prekur nga sindromi Down. Me këtë rast, shumica e nënave bien në depresion dhe ju nevojitet minimumi 1 (një) vit, derisa të marrin veten apo të rehabilitohen. Në këtë rast, nënave që janë në marrëdhënie pune, iu duhet një pushim më i gjatë i lehonisë se sa periudha 1 (një) vjeçare, pasi që nuk është njëjtë si të lindësh një fëmijë normal, në këtë rast, fëmijë me aftësi të kufizuar. Pra, kërkojmë nga ju që gjatë rishikimit të Ligjit të punës, të keni parasysh pushimin e lehonisë për këto nëna. Problem tjetër është se shumica e këtyre fëmijëve që janë të prekur me sindromin Down, vuajnë nga sëmundje tjera, si ajo e zemrës dhe sëmundje të tjera. Shqetësim i yni është se fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe nënat e tyre trajtohen jo në mënyrën e duhur në spitalet tona. Është i nevojshëm laborator, që të bëhet amiosinteza, e cila është e nevojshme për nënat të cilat kanë lindur fëmijën e parë me sindromin Down, e cila potencialisht mund të ketë edhe fëmijën e dytë të prekur. Shumica deri më tani e kanë bërë jashtë Kosovës dhe kushton mjaft shumë, diku mbi 400 €. Andaj, nga ju kërkojmë dhe shpresojmë shumë se këto shqetësime tona do të gjejnë përkrahjen tuaj dhe të institucioneve tona.

Flora Brovina – Ju falënderojmë për prezantimin punës dhe shqetësimeve tuaja, që ju si shoqatë përballeni për ofrimin e shërbimeve për këta persona. Andaj, unë po e hapi debatin.

Njomza Emini – Ju faleminderit kryetare, përshëndetje për përfaqësuesit e shoqatës “Down Syndrom Kosova”. Unë kam pasur kënaqësinë dhe nderin që të bashkëpunoj me ju, para se të bëhem deputete, sepse kam udhëhequr një organizatë të personave me aftësi të kufizuara. Personat me sindromin Down, janë të prekur nga ky sindrom, mirëpo nuk janë të ndryshëm nga fëmijët tjerë. Vlen të theksohet se sportistja jonë dhe anëtarja e juaj, znj. Medina Surdulli që e ka të drejtën e bursës para olimpike, e cila ka qenë pjesëmarrëse në shumë gara ndërkombëtare. Pra, kjo nënkupton që këta persona me sindromin Down, nuk janë të ndryshëm, pra janë të njëjtë sikurse fëmijët tjerë. Pra, duke e njohur këtë problematikë dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara, unë tash e kam më të lehtë, si deputete, respektivisht anëtare e këtij Komisioni, që të llobojë për të drejtat e këtyre personave. Ne si Komision, bashkërisht me të gjithë kolegët kemi diskutuar rreth mundësisë që përmes një ligji të vetëm të rregullohet statusi i personave me aftësi të kufizuara, tashmë nisma veç sa paska filluar dhe ne si Komision do të shqyrtojmë me kujdes të veçantë dhe do të keni përkrahjen tonë. Është e vërtetë se institucionet vendore dhe organizatat ndërkombëtare kanë dhënë një mbështetje, por jo aq sa duhet, pra sa janë nevojat e këtyre personave me aftësi të kufizuara. Mirëpo, shpresoj se me miratimin e ligjit i cili do të rregullojë

statusin dhe beneficionet e të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Po ashtu, të rregullohet edhe statusi i shoqatave që do të merren me të drejtat dhe ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Ju uroj suksese, që nesër në mbrëmjen humanitare që e keni organizuar, të mbledhni fonde sa më shumë për ndërtimin e qendrës për këta persona.

Besa Baftiu – Faleminderit kryetare! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në veçanti për përfaqësuesit e shoqatës “Down Syndrom Kosova”. Fillimisht, më lejoni që të shprehë brengën dhe dhimbjen me të gjithë ato familje që kanë fëmijë të prekur nga ky sindrom. Unë me profesion jam neonatologe dhe ballafaqohem shpeshherë që t’u jap lajmin e parë nënave të cilat e kanë të prekur fëmijën me këtë sindrom. Edhe unë shprehë shqetësimin tim, pasi që ligji nuk i trajton apo nuk ua njeh beneficionin në vitin e parë. E dimë që problemet më të mëdha janë në vitin e parë, sa i përket shëndetit të fëmijëve. Këta fëmijë, siç dihet, lindin edhe me probleme tjera, sidomos me anomali të zemrës, po ashtu me infeksione apo probleme aspiratore. Është shqetësuese se 16 vite mbas luftës, këto shoqata për persona me aftësi të kufizuara janë ende në mëshirën e donacioneve. Pra, edhe unë përkras idenë që të miratojmë një ligj të veçantë ku do të rregullohet statusi për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara apo t’i amendamentojmë ligjet ekzistuese në atë mënyrë që t’ua bëjmë jetën sa më të lehtë, pra nëse punohet me këta fëmijë. Mua më ka ra rasti t’i shoh dhe t’i përcjell qysh prej lindjes së tyre dhe me të vërtetë janë fëmijë të mrekullueshëm, krejt varet se sa punohet me këta fëmijë, dhe nëse punohet prej fillimit me këta fëmijë, edhe shoqëria edhe Qeveria do ta ketë më të lehtë që të investojë në këta fëmijë, që më vonë të mos bëhen raste sociale, siç e potencuat edhe ju.

Time Kadriaj – Faleminderit kryetare, përshëndetje për përfaqësuesit e shoqatës “Down Syndrom Kosova”. Më vjen mirë që keni gjetur kohë dhe iu keni përgjigjur ftesës pozitivisht dhe drejtpërsëdrejti t’i dëgjojmë shqetësimet apo hallet e juaja, me të cilat përballeni ju si shoqatë e fëmijëve me sindromin Down. Njëherazi ju përgëzoj për punën që e keni bërë deri më tani si shoqatë. Me të vërtetë keni bërë një punë shumë të madhe, pavarësisht se a keni qenë të përkrahur financiarisht, pasi që keni arritur që t’i largoni paragjykimet për këtë kategori të fëmijëve dhe këta fëmijë sot dalin dhe shëtisin rrugëve dhe të gjithë ne i shohim si pjesë e shoqërisë, të njëjtë me fëmijët tjerë, pa ndonjë paragjykim. Po ashtu, e vlerësoje këmbënguljen tuaj që po ndërmerrni nisma apo aktivitete që të mbledhni fonde për të bërë më të mirën, në këtë rast të ndërtoni edhe qendrën për këta fëmijë për zhvillim të aktiviteteve në të mirë të këtyre fëmijëve. Po ashtu, më vjen mirë që qenkeni edhe pjesë e grupit punues për hartimin e projektligjit për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Shpresojmë se ju do të keni mundësi, në kuadër të këtij grupi, që t’i inkorporoni apo shtyni kërkesat e juaja, mirëpo gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në Komision, siç u tha edhe nga kolegët e mi, do të keni përkrahjen tonë. Po ashtu, ju përgëzoj dhe ju uroj sukses edhe për iniciativën e gala mbrëmjes humanitare për mbledhjen e fondeve për ndërtim të qendrës për personat e prekur nga sindromi Down.

Fikrim Damka – Faleminderit kryetare, përshëndetje për mysafirët. Për mua, ju jeni heronj për punën që e bëni. Jam dëshmitar që nuk keni përkrahje institucionale. Unë kam disa pyetje për përfaqësuesit e shoqatës “Down Syndrome Kosova”. Në Ankara të Turqisë është mbajtur një konferencë ndërkombëtare dhe ne kemi pasur një kërkesë nga ana e tyre për pjesëmarrje që t’i dërgojmë 6 (gjashtë) fëmijë me sindromin Down, ku të gjitha shtetet e rajonit kanë marrë pjesë në këtë konferencë. Fatkeqësisht, institucionet e Kosovës, në këtë rast Ministria Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, nuk ka mundur që t’i përkrahë me 12 (dymbëdhjetë) bileta të avionit për këtë organizatë. Po ashtu, kemi kërkuar prej disa organizatave tjera, por nuk kemi hasur në mirëkuptim. Ju përgëzoj për iniciativën X21 dhe po ashtu keni një iniciativë tjetër sa i përket paketimit të mjaltit, në këtë rast, kush është duke ju përkrahur në këtë projekt, a keni kontaktuar

me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për përkrahjen apo subvencionim të këtyre iniciativave? Sa është numri në Kosovë i gjithë fëmijëve të prekur nga ky sindrom?

Sebahate Beqiri – Ju faleminderit për pyetjet. Sa i përket programit X21, është hapur në fund të vitit 2008, pra është kafiteri ku shërbejnë këta persona. Kurse sa i përket ndërmarrjes për paketimin e mjaltit, makina për paketim është dhuruar nga Oda Amerikane e Kosovës, ku kanë organizuar një mbrëmje bamirësie në vitin 2012 dhe nga fondet që janë mbledhur nga ajo mbrëmje, është blerë pajisja për paketim të mjaltit, një pjesë të mjeteve i ka dhënë edhe KEK-u, kurse për funksionalizim të kësaj ndërmarrjeje kemi fituar një projekt nga Komisioni Evropian, i cili ka zgjatur 18 muaj. Sa i përket numrit se sa persona janë të prekur në Kosovë nga ky sindrom, në bazë të dhënave që i kemi, janë diku mbi 800 persona. Ju jeni zëri ynë dhe përfaqësuesit tanë në institucionin më të lartë të vendit. Pra, është momenti i fundit që personat me aftësi të kufizuar të trajtohen me dinjitet dhe ky trajtim duhet të bëhet përmes ligjeve, mirëpo jo vetëm të rregullohet me ligje, por edhe të zbatohen ato ligje. Konceptin që e ka prezantuar Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është një koncept i mirë dhe besoj se do t'i përmbushë nevojat e personave me aftësi të kufizuara, pra është një koncept fillestar. Ne jemi pjesë e këtij grupi dhe do t'i paraqesim të gjitha kërkesat tona. Shpresojmë se do të përkrahet edhe nga ju gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në Kuvend.

Afrim Sahiti – Sa i përket pyetjes se a kanë kërkuar mbështetje nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për përkrahje apo subvencionim, Ministria i ka kryer obligimet doganore për pajisjen që është blerë për paketim të mjaltit.

Leunora Shabani-Bajraktari – Sa i përket statistikave të personave të prekur me këtë sindrom, në Kosovë, brenda vitit lindin 32 (tridhjetë e dy) deri 40 (dyzet) persona. Pra, është një numër jashtëzakonisht i madh, kurse para luftës ky numër ka qenë shumë me i vogël, diku 8 (tetë) fëmijë kanë lindur me këtë sindrom.

Flora Brovina – Më lejoni t'ju falënderoj për punën dhe angazhimin tuaj që e bëni për këta persona. Ne ju dëgjuam sa i përket punës dhe vështirësive, me të cilat ju përballeni gjatë punës suaj dhe mund të konstatojmë se, kjo çështje një kohë më parë ka qenë temë tabu dhe nuk mund të themi se asgjë nuk është bërë në shoqërinë tonë, të paktën janë miratuar ligjet që e rregullojnë këtë fushë, është bërë plani nacional. Natyrisht, që komisioni ynë ka për detyrë që të bëjë ndryshim-plotësimin e ligjeve të miratuara dhe evitimin e pengesave që ekzistojnë në ligje të caktuara. Kurse sa i përket kërkesave tuaja, ne tashmë jemi të informuar shumë mirë dhe do t'i adresojmë dhe do t'i trajtojmë brenda fushëveprimit të Komisionit. Jam shumë e befasuar, siç e potencuat se nuk bëhet amiosinteza, sepse është diçka që ne kemi njerëz të cilët janë të aftësuar për të bërë këtë dhe nuk është ndonjë procedurë shumë e rendë. Ne kemi edhe laboratorin citogjenetik, ku mund të bëhet amiosinteza dhe këtë çështje do ta adresojmë te Ministria e Shëndetësisë. Sa i përket Ligjit për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, është në program legjislativ, ne do të punojmë dhe do të trajtojmë me kujdes të veçantë, ku do t'i konsultojmë edhe grupet e interesit, të cilat do të shprehin gatishmëri për të kontribuar. Ju dëshirojmë suksese edhe në mbrëmjen të cilën e keni organizuar nesër. Siç e potencuan edhe kolegët, Komisioni ynë është i hapur dhe mund që t'i adresoheni çështjet tuaja edhe me shkrim, sa herë që ju vlerësoni se ne mund t'ju ndihmojmë. Ju faleminderit!

3. Raportimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit nr. 04/L-008, për Këshillin Ekonomiko-Social

Time Kadrijaj – Grupi punues, deri më tani, ka realizuar disa takime siç janë: takim me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me sekretariatit e KES-it, me Odën Ekonomike të Kosovës, me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, si dhe me Aleancën Kosovare të Biznesit. Kurse si takim përfundimtar, grupi punues ka planifikuar që të mbajë një seancë dëgjimore me gjithë anëtarët e Këshillit Ekonomiko- Social, me Komisionin.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këto

Përfundime:

- Komisioni vendosi që grupi punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko –Social, t'i takojë edhe dy sindikatat të cilat nuk janë të përfaqësuara në Këshillin Ekonomiko-Social. Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës - FSSHK dhe Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës të Republikës së Kosovës – SBASHK.
- Komisioni vendosi që grupi punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social, më 25 mars 2015, të organizojë një seancë dëgjimore, me të gjithë anëtarët e Këshillit Ekonomiko-Social.

4. Të ndryshme

Kryetarja – A ka dikush diçka te kjo pikë? Jo. Atëherë ju faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA